



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE  
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK

# BULETINI MUJOR I SEMUNDSHMERISE INFEKTIVE

(Pasqyra 14 Sh)

SEKTORI I EPIDEMIOLOGJISE

NENTOR, 2018

Buletini mujor i sëmundshmërisë infektive publikohet çdo muaj nga Sektori i Epidemiologjisë, Instituti i Shëndetit Publik. Ky buletin mujor bazohet në të dhënat e Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS) të raportuara përmes Pasqyrës mujore 14/Sh nga DRSHIP-te dhe DSHP-te. Ai plotësohet ne pasqyrën ne formatin EXCEL dhe dërgohet me postë elektronike dhe me poste zyrtare në DEKSI, Instituti i Shëndetit Publik, brenda datës 10 te çdo muaji. Te dhënat e agreguara te pasqyrës 14 sh për muajin Nëntor janë te dhënat e raportuara nga te 36 rrethet e vendit.

## 1. Semundjet diarreike

Sëmundjet diarreike, gjate muajit Nëntor 2018 zënë 32,8 % te totalit te sëmundjeve infektive te raportuara me ane te Pasqyrës 14 sh dhe paraqesin një incidencë 209.35/100.000 banorë. Gastroenteritet e paspecifikuara janë te shpërndara në të gjitha rrethet e vendit dhe zënë peshën kryesore ne grupin e sëmundjeve diarreike.

Në muajin nëntor janë raportuar katër raste te dyshuara me Tifo abdominale përkatësisht dy nga rrethi i Vlorës, një rast suspekt nga rrethi i Fierit dhe një rast nga rrethi i Librazhdit. Rasti nga rrethi i Librazhdit është ne moshën pediatrike, 2 vjeç, i shtruar dhe i konfirmuar ne QSUT. Nga ana e Shërbimit epidemiologjik, DSHP Librazhd janë marre te gjitha masat përkatëse dhe është kryer hetimi ne vatër.

Rrethi i Shkodrës mban peshën kryesore te incidencës së Salmonelozës jotifioide për muajin nëntor 2018 me 17 raste te konfirmuara ndjekur nga Berati, Korça dhe Vlora përkatësisht me vetëm nga një rast me Salmoneloze jotifioide. Te gjitha rastet janë te konfirmuara me laborator për muajin nëntor 2018.

Rrethi i Shkodrës mban peshën kryesore te incidencës së Shigelozës për muajin nëntor 2018 ne nivel kombëtar përkatësisht me 17 raste, ndjekur nga rrethi i Durrësit qe ka raportuar dy raste dhe Tirana dhe Kruja përkatësisht kane raportuar vetëm një rast.

Dy rastet te raportuara nga rrethi i Durrësit janë fëmije te moshës 4 dhe 5 vjeç te cilët frekuentojnë te njëjtin kopsht. Ata janë ndjekur dhe konfirmuar ne QSUT me Shigella sonnei. DRSHIP Durrës, Shërbimi i Epidemiologjisë kreu hetimin epidemiologjik te rasteve dhe morri masat përkatëse ne vatër dhe ne kopshtin qe frekuentohej nga fëmijët u krye dezinfektimi i kopshtit.

Ne muajin nëntor rrethi Tirane raporton një rast pozitiv me Shigelle sonnei, 5 vjeç, banor ne Baldushk. Shërbimi i epidemiologjisë monitoi kushtet e banesës se fëmijës dhe kopshtit qe fëmija frekuentonte dhe u be dezinfektimi i tyre. Gjithashtu u morën mostra nga uji i pusit te familjes dhe kopshtit. Nga analizat laboratorike, te dyja mostrat e ujit rezultuan me ndotje mikrobike. Familjareve dhe fëmijëve te kopshtit (20 fëmije përfshire dhe edukatoren) ju rekomandua analiza e koprokultures pranë DSHP, Tirane. Pas analizimit këto mostra rezultuan negative.

Ndërkohe qe ne nivel kombëtar toksikoinfekcionet alimentare paraqesin një incidencë 6.04/100.000 banorë. Rrethet Berat, Bulqizë, Kavajë, Kukës dhe Gjirokastrë mbajnë peshën kryesore ne raportimin e toksikoinfeksioneve alimentare.

Tabela 1: Frekuencat dhe incidencat e sëmundjeve diarreike për muajin Nëntor, 2018

(Incidenca raste/100.000 banore)

	Raste, Nëntor 2018	Incidenca Nëntor 2018 (raste/100.000 banorë)
Tifo abdominale + Paratifo	4	0.14
Salmonelozë	20	0.71
Shigelozë (Disenteri bacilare)	21	0.75
Dizenteri amebike	0.	0
Toksikoinfeksione alimentare	169	6.04
Gastroenterite (etiologji e panjohur)	5648	201.7
Semundje diarreike ne total	5862	209.35


## 2. Sëmundjet e EPI

### 2.1. Fruthi

Gjatë muajit nëntor 2018 në kuadrin e vazhdimësisë së epidemisë së fruthit janë dyshuar në total 59 raste prej te cilave janë konfirmuar me IgM pozitiv 31 raste. Nga këto 53 raste i përkasin rrethit te Tiranës. Rastet pozitive i përkasin kryesisht grupmoshës < 1 vjeç (18 raste) dhe 1-4 vjeç (17 raste). Kjo vazhdon te jete grupmosha me e

prekur për shkak edhe të mosvaksinimit dhe kontaktit apo vizitës të mëparshëm të tyre në shërbimin pediatrik QSUT. Të gjitha rastet janë konfirmuar në Laboratorin e Virologjisë, në ISHP.

Grafiku 1. Kurba epidemike e rasteve të dyshuara për fruth sipas datës së fillimit të rashit, Nëntor 2018



## 2.2. Tuberkulozi pulmonar

Gjatë muajit nëntor 2018 janë raportuar 17 raste me Tuberkuloz pulmonar dhe 4 raste me Tuberkuloz ekstrapulmonar, me anë të Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS) të raportuara përmes Pasqyrës mujore 14/Sh nga DRSHP-te dhe DSHP-te. Grupmosha e prekur është ajo adulte. Nga 17 raste të suspektuara 10 janë të konfirmuar me Tuberkuloz pulmonar dhe nga 4 raste të suspektuara me Tuberkuloz ekstrapulmonar vetëm 2 janë të konfirmuara.

## 2.3. PFA, Paralize e paspecifikuar

Gjate muajit nëntor rrethi i Fierit ka raportuar një rast suspekt PFA. U morën dy mostra rastit dhe nga ekzaminimi në Laboratorin e Virologjisë, ISHP dolën negativ megjithatë u krye investigimi i rastit dhe u morën masat përkatëse nga ana e DRSHP Fier.

### 3. Zoonozat

Ne nivel vendi incidenca e Brucelozës është 0.11/100.000 banore për muajin nëntor 2018. Rastet për muajin nëntor 2018 me Bruceloze janë raportuar nga rrethet Kolonje dhe Librazhd. Gjatë muajit nëntor me anë të Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS) të raportuara përmes Pasqyrës mujore 14/Sh nga DRSHP-te dhe DSHP-te janë raportuar vetëm: një rast suspekt leishmanie kutane dhe dy raste suspekt leptospiroze.

Tabela 2: Frekuenca dhe incidencat e sëmundjeve Zoonotike ne Nëntor 2018 (Incidenca raste/100.000 banore)

	Raste, Nëntor 2018	Incidenca Nëntor 2018 (raste/100.000 banore)
Antraks (Plasje)	0	0
Brucelozë	3	0.11
Leptospirozë	2	0.07
Leishmaniaza viscerale	0	0
Leishmaniaza kutane	1	0.04

### 4. Hepatitet virale

Ne raportimin mujor te sëmundshmërisë infektive gjate muajit nëntor 2018 janë raportuar ne total 9 raste me hepatite virale akute (Incidenca 0.32/100.000 banore) nga te cilat 6 raste janë Hepatite virale të paspecifikuar, 1 raste Hepatit viral akut A dhe 2 raste Hepatit viral B.

Ne lidhje me HBV, 2 rastet e konfirmuara janë raportuar përkatësisht nga Lushnja dhe Tirana.

### 5. Meningoencefalite

Gjate muajit Nëntor 2018 janë raportuar ne total 4 raste meningoencefalite bazuar neurvejancen case based te tyre. Rastet janë nga Tirana, Lezha dhe Vlora. Duke u mbështetur ne kliniken e secilit rast dhe ne ekzaminimin e likuorit cerebrospinal pranë laboratorit te QSUT, rastet janë raportuar ne DRSHP Tirane, Lezhe dhe Vlore si meningite bakterial jo meningokoksik dhe meningit viral. Rastet kane patur një shpërndarje si me poshtë : 2 raste te grup moshës pediatrike <5 vjeç dhe 2 raste te grupmoshës se rritur 35-54 vjeç. Raporti meshkuj ndaj femra është 2:2 . Theksojmë qe rastet nuk kane patur lidhje epidemiologjike me njeri tjetrin dhe kane patur ecuri te mire klinike.

## 6. Ethe hemorragjike

Gjate muajit Nëntor 2018 janë raportuar 4 raste te dyshuara me ethe hemorragjike, prej te cilave 3 raste rezultuan negative dhe nje rast pozitiv. Rastet kane patur një shpërndarje gjeografike te tille si: 2 raste ne Tirane, 1 rast nga Kukësi dhe 1 rast nga Librazhdi. Rastet kane patur një shpërndarje sipas grup moshës : 20-30 vjeç 2 raste dhe 55-60 vjeç 2 raste. Raporti meshkuj ndaj femra ishte 3:1. Rasti i rezultuar pozitiv ka patur fillimi te sëmundjes pese dite para hospitalizimit ne fund te muajit Tetor. Rasti ishte mashkull, moshë 23 vjeç, me profesion druvar, nga Stravë, Librazhd. Nga hetimi epidemiologjik rezultoi si rast i importuar, sepse punonte ne profesion ne një nga shtetet fqinj dhe koha e inkubacionit përkonte me periudhën e vendqëndrimit atje. Rasti u konfirmua me ethe hemorragjike Hantan nga laborator i virologjisë pranë ISHP. Në kuadër të bashkëpunimit ndërkufitar është komunikuar dhe rasti është raportuar në strukturat homologe nga vendi i importuar i sëmundjes

## 7. HIV/AIDS

Gjate muajit nëntor 2018 ne Laboratorin Referencës HIV/AIDS, ISHP Tirane, janë kryer 83 ekzaminime nga te cilët 13 janë vullnetare dhe gjashte kane ardhur nga banka e gjakut. Ne total janë konfirmuar 14 raste te reja me HIV+ te grup-moshës 19-80 vjeç përkatësisht: tete raste vine nga Tirana, dy nga Shkodra, nga Durrësi, Vlora, Lezha dhe Kruja përkatësisht nga një rast. Ne rastet e konfirmuara me HIV/AIDS mbizotërojnë meshkujt, 12 raste dhe vetëm dy janë femra. Nga rastet e ardhura për testim ne ISHP pese janë te referuar nga Reparti i Infektivit, QSUT, katër raste janë vullnetare, tre janë referuar nga shoqata, një nga burgu dhe një rast ka ardhur nga laboratorët private. Ne pasqyrën 14 sh është raportuar vetëm një rast pozitiv me HIV nga Vlora, femër e grupmoshës 15-19 vjeç.

INSTITUTI I  
SHENDETIT PUBLIK

DEKSI

